



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

Nr. 381 Prot

Kukës, 26.01.2024

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Tema e konsultimit:

“Për dhënie pëlqimi në parim, për dhënie me qira të pasurisë Nr. 2208 të llojit pyll (shkurre), pjesë të saj përkatësisht sipërfaqen prej 15 Ha pjesë e pasurisë në fshatin Kolsh, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës. Fusha e përdorimit të pronës që jepet me qira të jetë : “ Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj).”

Propozuesi i konsultimit:

Këshilli Bashkiak /Kryetari i Bashkisë / Sekretari i Këshillit Bashkiak /Drejtorja e Administrimit të Pyjeve e Kullotave

Informacion për konsultimin:

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), nenet 18, 54, Ligjin Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe Rregulloren e Organizimit e Funksionimit të Këshillit Bashkiak të miratuar me VKB Nr. 22, datë 25.02.2020, Bashkiak Kukës fton të gjithë banorët e fshatrave të Njesisë Administrative Kolsh të bëhen pjesë e vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak duke dhënë rekomandimet e sugjerimet e tyre në seancën e konsultimit publik për projektvendimin “Për dhënie pëlqimi në parim, për dhënie me qira të pasurisë Nr. 2208 të llojit pyll (shkurre), pjesë të saj përkatësisht sipërfaqen prej 15 Ha pjesë e pasurisë në fshatin Kolsh, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës. Fusha e përdorimit të pronës që jepet me qira të jetë : “ Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj).”

Vendi, koha e konsultimit: Konsultimi do të organizohet ditën e Enjte, me datë 15.02.2024, ora 12⁰⁰, në ambjentet e Shkollës 9-vjeçare Kolsh.

Aktorët pjesëmarrës në konsultim:

Nga organizatorët: Kryetari/Anëtarëte Këshillit Bashkiak/Sekretari i Këshillit Bashkiak, Drejtorja e Administrimit të Pyjeve e Kullotave

Nga të ftuarit: Banorë të fshatrave të Njesisë Administrative Kolsh, Kryetarë e Anëtarë të Kryesive të fshatrave, përfaqësues të shoqërisë civile, organizatave jofitimprurëse, medias dhe biznesit.

Forma e konsultimit: Marrja e opinioneve dhe mendimeve nga të pranishmit në konsultimin publik, nëpërmjet diskutimeve, pyetjeve, propozimeve dhe rekomandimeve, paraqitja e konkluzioneve në mbledhjen e komisionit përkatës dhe mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Shënim: Rekomandimet dhe sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni edhe në mënyrë elektronike në adresën info@kukes.gov.al

Me respekt,

Kryetari i Këshillit

Albert MUJA

